

VENDIM
Nr. 178, datë 7.8.2025

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË KESH SHA PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGINËS DHE REGJISTRIMIN FILLIMTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR HEC FIERZË, HEC KOMAN DHE HEC VAU I DEJËS

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, me nr. 1274/5 prot., datë 4.8.2025, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë KESH sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC Fierzë, regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës”, konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë KESH sh.a.

- Shoqëria KESH sh.a. është e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin, përkatësisht HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës, me licencë të rinovuar për një afat 30-vjeçar, në bazë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 2, datë 6.1.2012, është bërë modifikimi i kësaj licence, duke iu caktuar numri i identifikimit: licenca nr. 77, seria PM09SH.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën nr. 1203/2 prot., datë 18.6.2025, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe për regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës, në përputhje me nenin 6 të rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.

- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit, përfshirë karakteristikat teknike të impianteve, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, tipin e turbinave dhe gjeneratorëve, si dhe informacion mbi transformatorët dhe regjimin e punës.

- Gjithashtu, janë paraqitur të dhënat mbi matësit përkatës për secilin nga hidrocentralet, përfshirë kodin/identifikimin e pikës së matjes dhe numrin serial të matësit.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistrin elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se impiantet për të cilat kërkohet regjistrimi janë hidrocentrale me rezervuar, të cilët klasifikohen si impiante të përshtatshme për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6 të rregullores dhe tabelës 1.1 të saj.

- Gjithashtu, nga informacioni i paraqitur rezulton se këto impiante nuk janë të pajisura me sistem pompimi kthyes, dhe për rrjedhojë nuk përjashtohen nga përfitimi i garancive të origjinës, në përputhje me nenin 22, pika 7, të ligjit nr. 24/2023.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar të pajisjeve dhe hapjen e llogarisë në regjistër si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë KESH sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë të njoftojë shoqërinë KESH sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti